



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 1, QARKU SHKODËR,  
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 08.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr.1, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike;

**V Ë R E N**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1559 prot., datë 20.03.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarku Shkodër, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Shkodër që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015, për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për tetë (8) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Shkodër, me shkresën nr. 2590 prot, datë 30.04.2019, i ka paraqitur KQZ-së propozimet për ambiente të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për seicilën nga VNV-të e Qarkut Shkodër.



**Nr. 258 i Vendimit    Data 08.05.2019 e Vendimit    Ora 10:00 e Vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.1, Qarku Shkodër,  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Ambienti i propozuar për krijimin për VNV-në e KZAZ-së Nr.1, Qarku Shkodër, është:

1. Palestra e Shkollës 9-vjeçare "Abdyl Bajraktari", me sipërfaqe prej 650 m<sup>2</sup>;

Palestra e Shkollës 9-vjeçare "Abdyl Bajraktari" propozohet për herë të parë si ambient për VNV pasi është ambient i ri i ndërtuar pranë Shkollës 9-vjeçare "Abdyl Bajraktari" në Bashkinë Malësi e Madhe. Ambienti që ka shërbyer si VNV në zgjedhjet e 2017 ka qënë ambient privat në pronësi të shtetasit Hilmi Kukaj, Koplik qender, ambient i cili ka shërbyer gjithmonë si VNV për ZAZ nr.1

Ambienti i propozuar ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar,

### **V E N D O S I**

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 1, Qarku Shkodër, në Palestrën e Shkollës 9-vjeçare "Abdyl Bajraktari", me sipërfaqe prej 650 m<sup>2</sup>, Bashkia Malësi e Madhe.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 258 i Vendimit Data 08.05.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit**

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.1, Qarku Shkodër,  
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019